



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PRISHTINË - PRISTINA

PSH.nr.1166/21

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenkovic – Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “El-Bau” SH.P.K-Gjilan, kundër njoftimit për dhënie të kontratë, ku është rekomanduar për kontratë OE “Urban O.P”-Mitrovicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rikonstruimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale me infrastrukturë” me nr. të prokurimit: 622-20-2054-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Vushtrrisë”, më datën: 25.01.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “El-Bau” SH.P.K-Gjilan, kundër njoftimit për dhënie të kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rikonstruimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale me infrastrukturë ” me nr. të prokurimit 622-20-2054-1-1-1, iniciuar nga AK- KK-Vushtrrisë.

II. **ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull “Rikonstruimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale me infrastrukturë ” me nr. të prokurimit: 622-20-2054-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - “KK-Vushtrrisë”, dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “El-Bau” SH.P.K-Gjilan, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimin të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues “El-Bau” SH.P.K-Gjilan, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP me 28.12.2020 me nr.1166/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rikonstruimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale me infrastrukturë” me nr. të prokurimit 622-20-2054-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - “KK-Vushtrisë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 parag. 1 dhe 2, neni 6 parag.1, neni 7 parag. 1.2 dhe 4, neni 51 parag. 1, neni 56 parag. 1.1 dhe 1.3 parag.3, neni 59 parag.4, neni 60 parag.1 nënparag.1.1, si dhe nenin 61 parag.1 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenet 4.4, 26, 41 pika 3 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 30.12.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 13.01.2021, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Pretendimi i parë i OE ankues është se bazuar në shqyrtimin dhe analizën konkrete që ju është bërë ofertave financiare (paramasës dhe parallogaritë) të secilit OE pjesëmarrës është gjetur se ofertat e secilit prej tyre në shumicën e pozicioneve që përbëjnë lëndën kryesore të kontratës paraqesin çmime manipulative respektivisht tender jo-normalisht të ulët. OE “URBAN OP” në shumicën e pozicioneve të paramasës dhe parallogarisë që përbëjnë lëndën kryesore të kontratës ka ofertuar me çmime manipulative /mashtuese që nuk korrespondojnë me çmimet reale të tregut (min e tavanit) dhe atë ne pozicionet si në vijim: dhe. Pozicionin nr. E 2. Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave deri në deponime regjionale të menaxhuar nga UNITETI - për të cilin OE-të e paraqitur në tabelë për ton 1 Ton kanë ofruar çmim prej 3.50 euro.

Kërkesa e AK ka qenë që mbeturinat sipas pozicionit 1 Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave deri në deponinë regjionale të menaxhuar nga UNITETI ndërsa çmimorja e deponisë KRM-“UNITETI” sh.a vetëm për hedhjen e mbeturinave për këtë pozicion është çmimi prej 6.10 euro për ton që i bie se OE “URBAN O.P

” ka ofruar çmim jo normalisht të ulët me çmim prej 3.5 euro për ton, kur e kemi parasysh edhe koston e transportit që i bie afër 15 km tregon që kemi të bëjmë me çmim manipulativ. Pozicionin nr. E 3. Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave ushqimore (mbetjet e asgjësimit) si dhe mbeturinat shtazore, deri në deponinë regjionale të menaxhuar nga UNITETI – për të cilin OE-të e paraqitura në tabelë për 1 Ton kanë ofruar çmim prej 3.50 euro.

Kërkesa e AK ka qenë që mbeturinat sipas pozicionit 2 Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave ushqimore (mbetjet e asgjësimit) si dhe mbeturinat shtazore, deri në deponinë regjionale të menaxhuar nga UNITETI ndërsa çmimorja e deponisë KRM-“UNITETI” sh/a vetëm për hedhjen e mbeturinave për këtë pozicion është çmimi prej 60.00 euro për ton që i bie se OE “URBAN O.P” ka ofruar çmim jo normalisht të ulët me çmim prej 3.5 euro për ton, kur kemi parasysh koston e transportit që i bie afër 15 km, tregon që kemi të bëjmë me çmim manipulativ sepse ka ofruar një çmim prej 56.50 euro për ton më lirë se çmimi i hedhjes në deponi.

Pozicioni nr.E 4. Dislokimi i shtyllave ekzistuese të drurit dhe zëvendësimi i tyre me shtylla të betonit me lartësi H=9 m këndore tip 40°, me bazament të betonit duke përfshirë gërmimin për bazament me dimensione (1.0 x 1.0 x 1.5) m, vendosjen e betonit, shiritin e tokëzimit Fe/Zn 25 x 4 mm (3.5m), rërën e imët, montimi i sërishëm i kabllove ekzistuese ajrore dhe nëntokësore eventuale dhe materiali tjetër i nevojshëm komplet me ateste për një shtyllë të dislokuar. Për të cilin OE-të e paraqitura në tabelë për 1 Copë kanë ofruar çmim prej 5.00 euro.

Është e pamundur që të bëhet dislokimi dhe zëvendësimi me shtylla betoni me lartësi H=9 m duke pasur parasysh edhe bazën dhe gjithë materialin e nevojshëm për vendosjen e shtyllave me një çmim prej 5. euro dhe këtu kemi të bëjmë me një çmim jo normalisht të ulët sepse kosto e këtij pozicioni është rreth 400-450 euro. Pozicionin nr. I kategoria E 20%_Kërkesa e AK ka qenë që mbeturinat sipas pozicionit rregullimi i bubëzave të betonit (në çmim të përfshihet stabilizimi i terenit, shtresa e materialit 0-31,5, shtresa nga tamponi, vendosja e bubëzave, ngjeshja etj.) Për të cilin OE-të e paraqitura në tabelë për m² kanë ofruar çmim prej 4.00 euro. Këtu kemi të bëjmë me çmim manipulativ për arsye se nuk ka mundësi që të realizohet ky pozicion me një çmim prej 4.00 euro. Eksperti shqyrtues duke u bazuar në Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët ka bërë llogaritjet për pozicionet si me poshtë:

LLOGARITJA E POZICIONIT I KATEGORIA E 20%

N r.	POZICIONI I KATEGORIA E 20%			
	A	B	C	D
1	kushti I - është përbushur kushti i pare sepse janë			PO

	pranuar me shume se tri oferta			
2	OE HYSNIA	1	2.50	
3	OE ORBAN O.P	2	4.00	
4	OE EL- BAU	3	16.00	
5	OE VIKTORIA INVES &MONDIAL SOL L.L,C	4	18.00	
6		5		
7		6		
8		Total (C2+C3+C4+C5+C6+C7)	40.50	
9		mesatarja (C8/6)	6.75	
10	kushti 2 - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	pragu 30% (mesatarja /1.3)	5.19	Ne ketë rast oferta nr.2 nuk përmbush kushtin e dyte prandaj NUK vazhdohet me kushtin e trete
11	kushti 3 – pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire	pragu 10% (oferta e dyte /1.1)	14.55	Oferta e dyte plotëson edhe kushtin e trete (10%) sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shume se 10% me i ulet

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi
1	Janë pranuar me shume se 3 oferta	Është plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta
2	Çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm	Oferta e dyte në këtë pozicion plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulet se mesatarja e tenderëve. Shih prapun ne kolonën C10
3	Çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët	Oferta e dyte nuk plotëson edhe kushtin e trete (10%) në këtë pozicion sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shum; se 10% me i ulet. Shih prapun C11
Konkludim		Oferta me nr. rendor 2 plotëson 3 kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhoje mund te konsiderohet si oferte abnormalisht e ulet në këtë pozicion

LLOGARITJA E POZICIONIT 2 KATEGORIA E 20%

Nr.	POZICIONI 2 KATEGORIA E 20%			
	A	B	C	D

1	kushti 1 - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta	Pranuar 4 oferta		PO
2	OE HYSNIA	1	2.50	
3	OE ORBAN O.P	2	3.50	
4	OE EL- BAU	3	9.00	
5	OE VIKTORIA INVES &MONDIAL SOL L.L,C	4	15.00	
6		5		
7		6		
8		Total (C2+C3+C4+C5+C6+C7)	30.00	
9		mesatarja (C8/6)	5.00	
10	kushti 2 - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	pragu 30% (mesatarja /L3)	3.85	Ne ketë rast oferta nr.2 nuk përmbush kushtin e dyte prandaj nuk vazhdohet me kushtin e trete
11	kushti 3 – pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire	pragu 10% (oferta e dyte /L1)	8.18	Oferta e dyte plotëson edhe kushtin e trete (10%) sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shume se 10% me i ulet

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi
1	Janë pranuar me shume se 3 oferta	Është plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta
2	Çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm	Oferta e dyte në këtë pozicion plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulet se mesatarja e tenderëve. Shih pragu ne kolonën C10
3	Çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët	Oferta e dyte nuk plotëson edhe kushtin e trete (10%) në këtë pozicion sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shumë se 10% me i ulet. Shih pragu C11
Konkludim		Oferta me nr. rendor 2 plotëson 3 kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhoje mund te konsiderohet si oferte abnormalisht e ulet në këtë pozicion

LLOGARITJA E POZICIONIT 3 KATEGORIA E 20%

POZICIONI 3 KATEGORIA E 20%				
	A	B	C	D
1	kushti 1 - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar me shume se 3 oferta			PO
2	OE HYSNIA	1	2.50	
3	OE ORBAN O.P	2	3.50	
4	OE EL- BAU	3	64.00	
5	OE VIKTORIA INVES &MONDIAL	4	15.00	

	SOL L.L.C			
8		Total (C2+C3+C4+C5+C6+C7)	85.00	
9		mesatarja (C8/6)	14.17	
10	kushti 2 - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	pragu 30% (mesatarja /1.3)	10.90	Ne ketë rast oferta nr.2 përmbush kushtin e dyte prandaj vazhdohet me kushtin e trete
11	kushti 3 – pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire	pragu 10% (oferta e dyte /1.1)	13.63	Oferta e dyte plotëson edhe kushtin e trete (10%) sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shume se 10% me i ulet

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi
1	Janë pranuar me shume se 3 oferta	Është plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta
2	Çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm	Oferta e dyte në këtë pozicion plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulet se mesatarja e tenderëve. Shih pragun ne kolonën C10
3	Çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët	Oferta e dyte nuk plotëson edhe kushtin e trete (10%) në këtë pozicion sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shumë se 10% me i ulet. Shih pragun C11
Konkludim		Oferta me nr. rendor 2 plotëson 3 kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhojë mund te konsiderohet si oferte abnormalisht e ulet në këtë pozicion

LLOGARITJA E POZICIONIT 4 KATEGORIA E 20%

Nr.	POZICIONI 4 KATEGORIA E 20%			
	A	B	C	D
1	kushti 1 - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar me shume se tri oferta			PO
2	OE HYSNIA	1	240	
3	OE ORBAN O.P	2	5.00	
4	OE IL- BAU	3	430.00	
5	OE VIKTORIA INVES &MONDIAL SOL L.L.C	4	120.00	
8		Total (C2+C3+C4+C5+C6+C7)	555.00	

9		mesatarja (C8/6)	92.50	
10	kushti 2 - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	pragu 30% (mesatarja /1.3)	71.15	Ne këtë rast oferta nr.2 përmbush kushtin e dyte prandaj vazhdohet me kushtin e trete
11	kushti 3 – pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire	pragu 10% (oferta e dyte /1.1)	109.10	Oferta e dyte plotëson edhe kushtin e trete (10%) sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shume se 10% me i ulet

Kusht i	Kërkesa	Arsyetimi
1	Janë pranuar me shume se 3 oferta	Është plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta
2	Çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm	Oferta e dyte në këtë pozicion plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulet se mesatarja e tenderëve. Shih prapun ne kolonën C10
3	Çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët	Oferta e dyte plotëson edhe kushtin e trete (10%) në këtë pozicion sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shume se 10% me i ulet. Shih prapun C11
Konkludim		Oferta me nr. rendor 2 plotëson 3 kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhoje mund te konsiderohet si oferte abnormalisht e ulet në këtë pozicion

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët neni 3 dhe 4 Informatat e përgjithshme ku thotë: 3.1 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen te gjitha kushtet e mëposhtme:

çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;

çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;

janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë. Neni 4 Procedura e shqyrtimit (inter partes)

4.1 Kur një tender konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim me Nenin 61 te LPP dhe paragrafit 3.1 ose 3.2 te këtyre rregullave, një tender i tille nuk mund të refuzohet pa hetimin dhe shqyrtimin e elementeve të rëndësishme që shkaktoj tenderin veçanërisht të ulët.

4.2 Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë abnormalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ultë, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët". 4.3 Operatori Ekonomik do t'i përgjigjet me shkrim Autoritetet Kontraktues. Nëse jo, tenderi do të refuzohet. 4.7 Tenderuesi në fjalë do të informohet për rezultatin final të vlerësimit. Me tej eksperti shqyrtues sqaron se bazuar në llogaritjet e bëra për pozicionet ku

OE ankues pretendon se janë ab-normalisht të ultë, konstaton se tek pozicioni nr.1,2,3 dhe 4, OE i rekomanduar për kontratë ka sjellë çmim jo-normalisht të ulët, dhe si rrjedhojë OE i rekomanduar për kontratë konsiderohet si ofertë ab-normal e ulët në pozicion në fjalë. Prandaj bazuar në sqarimet që u dhanë më lartë del ky pretendim ankimor është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Pretendimi tjetër i OE ankues është se OE N.N.P “HYSNIA” në shumicën e pozicioneve të paramasës dhe parallogaritë që përbëjnë lëndën kryesore të kontratës ka ofertuar me çmime manipulative/mashtuese që nuk korrespondojnë me pozicionet si në vijim: dhe çmimet reale të tregut (min e tavanit) dhe atë në Pozicionin nr.E 2. Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave deri në deponinë regjionale të menaxhuar nga UNITETI – për të cilin OE-të e paraqitura në tabelë për 1 Ton kanë ofruar çmim prej 2.50 euro. Kërkesa e AK ka qenë që mbeturinat sipas pozicionit 1 ngarkimi dhe transporti i mbeturinave deri në deponinë regjionale të menaxhuar nga UNITETI ndërsa çmimorja e deponisë KRM-“UNITETI”sh.a vetëm për hedhjen e mbeturinave për këtë pozicion është çmimi prej 6.10 euro për ton që i bie se OE “HYSNIA” ka ofruar çmim jo normalisht të ulët me çmim prej 3.5 euro për ton, kur kemi parasysh edhe koston e transportit që i bie afër 15 km tregon që kemi të bëjmë me çmim manipulativ. Pozicionin nr, E 3. Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave ushqimore (mbetjet e asgjësimit) si dhe mbeturinat shtazore, deri në deponinë regjionale të menaxhuar nga UNITETI – për të cilin OE-të e paraqitura në tabelë për 1 Ton ofruar çmim prej 2.50 euro. Kërkesa e AK ka qenë që mbeturinat sipas pozicionit 2 Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave ushqimore (mbetjet e asgjësimit) si dhe mbeturinat shtazore, deri në deponinë regjionale të menaxhuar nga UNITETI ndërsa çmimorja e deponisë KRM-“UNITETI” sh.a vetëm për hedhjen e mbeturinave për këtë pozicion është çmimi prej 60.00 euro për ton që i bie se OE “HYSNIA”ka ofruar çmim jo normalisht të ulët me çmim prej 2.5 euro për ton, kur kemi parasysh edhe koston e transportit që i bie afër 15 km tregon që kemi të bëjmë me çmim manipulativ sepse ka ofruar një çmim prej 57.50 euro për ton më lirë se çmimi i hedhjes në deponi. Eksperti shqyrtues duke u bazuar në Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët ka bërë llogaritjet si në vijim:

LLOGARITJA E POZICIONI 3 KATEGORIA E 20%

POZICIONI 3 KATEGORIA E 20%				
	A	B	C	D
1	kushti 1 - është përmbushur kushti i parë sepse janë pranuar më shumë se tri oferta			PO
2	OE ORBAN O.P	1	3,50	

3	OE HYSNIA	2	2,50	
4	OE EL- BAU	3	64,00	
5	OE VIKTORIA INVES &MONDIAL SOL L.L,C	4	15,00	
6		5		
7		6		
8		Total (C2+C3+C4+C5+C6+ C7)	85,00	
9		mesatarja (C8/6)	14,17	
10	kushti 2 - te gjitha ofertat nen ketë çmim përbushin kushtin e dye	pragu 30% (mesatarja /1.3)	10,90	Ne ketë rast oferta nr.2 përbush kushtin e dye prandaj vazhdohet me kushtin e trete
11	kushti 3 – pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dye me te lire	pragu 10% (oferta e dye /1.1)	13,64	Oferta e dye plotëson edhe kushtin e trete (10%) sepse ne krahasim me ofertën e dye me radhe është me shume se 10% me i ulet

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi
1	Janë pranuar me shume se 3 oferta	Është plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta
2	Çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm	Oferta e dye në këtë pozicion plotëson kushtin e dye (30%) sepse çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulet se mesatarja e tenderëve. Shih pragu ne kolonën C10
3	Çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët	Oferta e dye plotëson edhe kushtin e trete (10%) në këtë pozicion sepse ne krahasim me ofertën e dye me radhe është me shume se 10% me i ulet. Shih pragu C11
Konkludim		Oferta me nr. rendor 2 plotëson 3 kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhoje mund te konsiderohet si oferte abnormalisht e ulet në këtë pozicion

LLOGARITJA E POZICIONI 2 KATEGORIA E 20%

POZICIONI 2 KATEGORIA E 20%				
	A	B	C	D
1	kushti 1 - është përmbushur kushti i parë sepse janë pranuar 6 oferta	Pranuar 4 oferta		PO
2	OE ORBAN O.P	1	3,50	
3	OE HYSNIA	2	2,50	
4	OE EL- BAU	3	9,00	
5	OE VIKTORIA INVES & MONDIAL SOL L.L.C	4	15,00	
8		Total (C2+C3+C4+C5+C6+C7)	30,00	
9		mesatarja (C8/6)	5,00	
10	kushti 2 - të gjitha ofertat nën këtë çmim përmbushin kushtin e dytë	pragu 30% (mesatarja /1.3)	3,85	Ne këtë rast oferta nr.2 përmbush kushtin e dytë prandaj vazhdohet me kushtin e tretë
11	kushti 3 – pragu 10% në mes ofertës me të lirë në krahasim me ofertën e dytë me të lirë	pragu 10% (oferta e dytë /1.1)	3,18	Oferta e dytë plotëson edhe kushtin e tretë (10%) sepse në krahasim me ofertën e dytë me radhë është me shumë se 10% më i ulët

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi
1	Janë pranuar më shumë se 3 oferta	Është plotësuar kushti i parë sepse janë pranuar 6 oferta
2	Çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm	Oferta e dytë në këtë pozicion plotëson kushtin e dytë (30%) sepse çmimi i ofruar është me shumë se 30% më i ulët se mesatarja e tenderëve. Shih pragu në kolonën C10
3	Çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët	Oferta e dytë plotëson edhe kushtin e tretë (10%) në këtë pozicion sepse në krahasim me ofertën e dytë me radhë është me shumë se 10% më i ulët. Shih pragu C11
Konkludim		Oferta me nr. tender 2 plotëson 3 kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhojë mund të konsiderohet si ofertë abnormalisht e ulët në këtë pozicion

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në kategorinë E 20% e pikëve në vlerësim tek pozicionin nr.3 Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave ushqimore (mbetjet e asgjësimit) si dhe mbeturinat shtazore, deri ne deponinë regjionale te menaxhuar nga UNITETI. Dhe në pozicionin 2. Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave ushqimore (mbetjet e asgjësimit) si dhe mbeturinat shtazore, deri ne deponinë regjionale te menaxhuar nga UNITETI –OE “HYSNIA “ka ofruar çmim prej 2.50 € për këtë pozicion. Sa i përket këtyre pozicioneve eksperti shqyrtues bazuar në llogaritjet e bëra konstaton se OE ka sjellë çmime jo-normalisht të ulëta ne të dy pozicionet. Bazuar në sqarimet që u dhanë më lartë del se ky pretendim ankimor qëndron.

Përgjigje në Pretendimi nr. 3

Pretendimi tjetër i OE ankues është se OE N.P “Victoria Invest international “& MONDIAL SOL L.L.C në shumicën e pozicioneve të paramasës dhe parallogarisë që përbëjnë lëndën kryesore të kontratës ka ofertuar me çmime manipulative /mashtuese që nuk korrespondojnë me çmimet reale të tregut (min e tevanit) për disa pozicione ka ofruar çmime enorme të larta siç është pozicioni 1 Shënimi i trases se kanalizimit ku ka ofruar çmim prej 25.00 euro për m1 e disa pozicione të tjerë të cilët është dashur qe AK gjatë vlerësimit ti vlerësoj dhe jo të shpall si të pa suksesshëm një operator i cili ka manipuluar me çmime. Po ashtu ka ofruar edhe çmime manipulative extreme të ulëta siq është pozicioni C7 furnizimi,planifikimi, shpërndarja dhe ngjeshja me cilindër adekuat 16 T te materialit nga gurëthyesi me fraksion 0-31mm, çmimi për m³ i ofruar prej 0.30 cent.

Pozicionin nr.E 3._Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave ushqimore (mbetjet e asgjësimit) si dhe mbeturinat shtazore, deri ne deponinë regjionale te menaxhuar nga UNITETI – për të cilin OE-të e paraqitura në tabelë për 1 Ton kanë ofruar çmim prej 15.00 euro.

Kërkesa e AK ka qenë qe mbeturinat sipas pozicionit 2 Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave ushqimore (mbetjet e asgjësimit) si dhe mbeturinat shtazore, deri ne deponinë regjionale te menaxhuar nga UNITETI – ndërsa çmimorja e deponisë KRM-“UNITETI” sh.a vetëm për hudhjen e mbeturinave për këtë pozicion është çmimi prej 60.00 euro për ton qe i bie se OE “N.P Victoria Invest International”& MONDIAL SOL L.L.C” ka ofruar çmim jo normalisht të ulët me çmim prej 2.5 euro për ton, kur e kemi parasysh edhe koston e transportit qe i bie afër 15 km tregon qe kemi te bëjmë me çmim manipulativ sepse ka ofruar një çmim prej 45.00euro për ton me lirë se çmimi i hedhjes ne deponi. Eksperti shqyrtues duke u bazuar në Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët dhe dokumentacionin në lëndë ka bërë llogaritjet si me poshtë:

LLOGARITJA E POZICIONIT 7 KATEGORIA C 20%

Nr.	POZICIONI 7 KATEGORIA E 20%			
	A	B	C	D

1	kushti 1 - është përmbushur kushti i parë sepse janë pranuar 6 oferta			PO
2	OE HYSNIA	1	8,00	
3	OE VIKTORIA INVE &MONDIAL SOL L.L.C	2	0,30	
4	OE EL-BAU	3	14,00	
5	OE ORBAN O.P	4	9,50	
8		Total (C2+C3+C4+C5+C6+C7)	31,80	
9		mesatarja (C8/6)	5,30	
10	kushti 2 - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	pragu 30% (mesatarja /1.3)	4,08	Ne këtë rast oferta nr.2 nuk përmbush kushtin e dytë prandaj NUK vazhdohet me kushtin e trete
11	kushti 3 – pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire	pragu 10% (oferta e dyte /1.1)	7,27	Oferta e dyte plotëson edhe kushtin e trete (10%) sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shume se 10% me i ulet

Kushti	Kërkesa	Arsyetime
1	Janë pranuar me shume se 3 oferta	Është plotësuar kushti i parë sepse janë pranuar 6 oferta
2	Çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm	Oferta e dyte në këtë pozicion plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulet se mesatarja e tenderëve. Shih praguin ne kolonën C10
3	Çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët	Oferta e dyte plotëson edhe kushtin e trete (10%) në këtë pozicion sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shume se 10% me i ulet. Shih praguin C11
Konkludim		Oferta me nr. rendor 2 plotëson 3 kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhoje mund te konsiderohet si oferte abnormale dhe i ulet në këtë pozicion

LLOGARITJA E POZICIONIT 3 KATEGORIA E 20%

POZICIONI 3 KATEGORIA E 20%				
	A	B	C	D
1	kushti 1 - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar me shume se tri oferta			PO
1	kushti 1 - është			PO

	përbushur kushti i pare sepse janë pranuar me shume se tri oferta			
2	OE HYSNIA	1	2,50	
3	OE VIKTORIA INVES &MONDIAL SOL L.L.C	2	15,00	
4	OE EL- BAU	3	64,00	
5	OE ORBAN O.P	4	3,50	
8		Total (C2+C3+C4+C5+C6+ C7)	85,00	
9		mesatarja (C8/6)	14,17	
10	kushti 2 - te gjitha ofertat nen ketë çmim përbushin kushtin e dyte	pragu 30% (mesatarja /1.3)	10,90	Ne ketë rast oferta nr.2 nuk përbush kushtin e dyte prandaj vazhdohet me kushtin e trete
11	kushti 3 – pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire	pragu 10% (oferta e dyte /1.1)	58.18	Oferta e dyte plotëson edhe kushtin e trete (10%) sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shume se 10% me i ulet

Kusht	Kërkesa	Arsyetimi
-------	---------	-----------

i		
1	Janë pranuar me shume se 3 oferta	Është plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta
2	Çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm	Oferta e dyte në këtë pozicion plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulet se mesatarja e tenderëve. Shih pragun ne kolonën C10
3	Çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët	Oferta e dyte plotëson edhe kushtin e trete (10%) në këtë pozicion sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shume se 10% me i ulet. Shih pragun C11
Konkludim		Oferta me nr. rendor 2 plotëson 3 kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhoje mund te konsiderohet si oferte abnormalisht e ulet në këtë pozicion

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne kërkesat e AK ne DT. Pozicionin nr.3 kategoria E 20%. Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave ushqimore (mbetjet e asgjesisimit) si dhe mbeturinat shtazore, deri ne deponinë regjionale te menaxhuar nga UNITETI, Po ashtu edhe Pozicionin 2 të kësaj kategorie. Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave ushqimore (mbetjet e asgjesisimit) si dhe mbeturinat shtazore, deri ne deponinë regjionale të menaxhuar nga UNITETI –konstaton se pas llogaritjeve del se OE “N.P Victoria Invest International”& MONDIAL SOL L.L.C” ka sjellë çmime jo-normalisht të ultë për këto pozicione dhe si i tillë ky pretendim ankimor qëndron.

Përgjigje në pretendimin nr. 4.

Pretendimi tjetër i OE ankues është se Kompania El-Bau sh.p.k me njoftimin për kontratë i cili është publikuar në Komunën e Vushtrrisë lidhur me projektin “Rikonstruimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale me Infrastruktur” ka analizuar paramasën te cilën e ka publikuar AK dhe për pozicionet në fjalë kemi marrë çmimoren për deponi në KRM “UNITETI”sh.a te cilën edhe gjatë ofertimit e kemi ngarkuar në sistemin elektronik të e-prokurimit me numër rendor 11 andaj duke ditur rëndësinë e këtij projekti ne i'u kemi përmbajtur plotësisht kërkesave të paraqitura në dosjen e tenderit, ndërsa Operatorët tjerë shihet se kanë manipuluar me çmime duke ofruar me çmime jo normalisht të ulëta, shtrohet pyetja si ka të drejtë qe AK Komuna e Vushtrrisë të shpall fitues një Operator i cili ka ofruar çmim prej 56.50 euro apo 940% më lirë se kosto e deponimit, kur kihet parasysh se këtu hyn edhe kosto e transportit. Andaj kërkojmë nga AK qe të bën vlerësimin duke u bazuar në kërkesat të cilat i ka paraqitur në dosjen e tenderit sepse AK ka kërkuar qe mbeturinat të hedhen në deponi dhe jo në lumenj sepse çmimi me të cilin kanë ofertuar këta operator me këtë çmim mbeturinat rrezikohen të hedhen në lumenj dhe jo në deponi.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në dokumentacionin në lëndë konstaton se qëndron fakti se OE ankues ka bashkangjitur çmimoren nga KRU Uniteti dega Mitrovic, gjithashtu qëndron fakti se OE i rekomanduar për kontratë dhe OE të tjerë për të cilët ka pretendime ankimore në disa nga pozicionet se kanë sjellë çmime me të ulët në krahasim me çmimoren e KRM Uniteti, eksperti shqyrtues pas krahasimit të çmimoreve të KRM UNITETI sh.a dhe çmimet në paramasat e OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit konstaton se OE-kë në disa pozicione kanë ofruar çmime me të ulta, dhe si i tillë ky pretendim ankimor qëndron. Gjithashtu sa i përket këtyre pikave ankimore eksperti shqyrtues sqaron se bazuar në Njoftimin mbi vendimin e AK-së në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar ku AK ka dhënë për disa pozicione çmimin me TVSH referent nga hulumtimi i tregut dhe për të njëjtat pozicione OE” EING COM” SH.P.K, “AVAG GROUP “SH.PK, është eliminuar, eksperti shqyrtues duke u bazuar në neni 7 Barazia në trajtim/jo-diskriminimi ku thotë se: Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Eksperti shqyrtues vjen në përfundim se AK-ës KK Vushtrri nuk ka trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë OE pjesëmarrës në këtë AP pasi që edhe OE-kë i rekomanduar për kontratë dhe OE të tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit kanë sjellë çmime me të ulta në disa pozicione se sa çmimet referente të tregut nga ana e AK-së dhe në Njoftimin mbi vendimin e AK-së janë shpallur si të pasuksesshëm.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 14.01.2021 me raportin e ekspertizës.

Operatori ekonomik “El-Bau” SH.P.K - Gjilan, me datë 15.01.2021 me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 25.01.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli Shqyrtues sqaron se pretendimi i OE ankues është se bazuar në shqyrtimin dhe analizën konkrete që ju është bërë ofertave financiare (para masës dhe parallogaritë) të secilit OE pjesëmarrës, është gjetur se ofertat e secilit prej tyre në shumicën e pozicioneve që përbëjnë lëndën kryesore të kontratës paraqesin çmime manipulative respektivisht tender jo-normalisht të ulët. OE “URBAN OP” në shumicën e pozicioneve të paramasës dhe parallogarisë që përbëjnë lëndën kryesore të kontratës ka ofertuar me çmime manipulative /mashtroese që nuk korrespondojnë me çmimet reale të tregut (min e tavanit) dhe atë ne pozicionet si në vijim: dhe. Pozicionin nr. E 2. Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave deri në deponime regjionale të menaxhuar nga UNITETI - për të cilin OE-të e paraqitur në tabelë për ton 1 Ton kanë ofruar çmim prej 3.50 euro. Më tej, OE ankues shton se kërkesa e AK ka qenë që mbeturinat sipas pozicionit 1 Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave deri ne deponinë regjionale te menaxhuar nga UNITETI ndërsa çmimorja e deponisë KRM-“UNITETI” sh.a vetëm për hedhjen e mbeturinave për këtë pozicion është çmimi prej 6.10 euro për ton që i bie se OE “URBAN O.P ” ka ofruar çmim jo normalisht te ulët me çmim prej 3.5 euro për ton, kur e kemi parasysh edhe koston e transportit që i bie afër 15 km tregon që kemi të bëjmë me çmim manipulativ. Pozicionin nr. E 2. Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave ushqimore (mbetjet e asgjësimit) si dhe mbeturinat shtazore, deri ne deponinë regjionale te menaxhuar nga UNITETI – për të cilin OE-të e paraqitura në tabelë për 1 Ton kanë ofruar çmim prej 3.50 euro. Tutje, OE ankues shton: kërkesa e AK ka qenë që mbeturinat sipas pozicionit 2 Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave ushqimore (mbetjet e asgjësimit) si dhe mbeturinat shtazore, deri ne deponinë regjionale te menaxhuar nga UNITETI ndërsa çmimorja e deponisë KRM-“UNITETI” sh/a vetëm për hedhjen e mbeturinave për këtë pozicion është çmimi prej 60.00 euro për ton që i bie se OE “URBAN O.P” ka ofruar çmim jo normalisht të ulët me çmim prej 3.5 euro për ton, kur kemi parasysh koston e transportit që i bie afër 15 km, tregon që kemi të bëjmë me çmim manipulativ sepse ka ofruar një çmim prej 56.50 euro për ton më lirë se çmimi i hedhjes ne deponi. Pastaj, OE ankues në vazhdim të pretendimeve ka cekur: pozicioni nr.E 4. Dislokimi i shtyllave ekzistuese te drurit dhe zëvendësimi i tyre me shtylla te betonit me lartësi H=9 m këndore tip 40°, me bazament te betonit duke përfshirë gërmimin për bazament me dimensione (1.0 x1.0 x 1.5) m, vendosjen e betonit, shiritin e tokëzimit Fe/Zn 25 x 4 mm (3.5m), rërën e imët, montimi i sërishëm i kablllove ekzistuese ajrore dhe nëntokësore eventuale dhe materiali tjetër i nevojshëm komplet me ateste për një shtyllë të dislokuar. Për të cilin OE-të e paraqitura në tabelë për 1 Copë kanë ofruar çmim prej 5.00 euro. Është e pamundur që të bëhet dislokimi dhe zëvendësimi me shtylla betoni me lartësi H=9 m duke pasur parasysh edhe bazën dhe gjithë materialin e nevojshëm për vendosjen e shtyllave me një çmim prej 5. euro dhe këtu kemi të bëjmë me një çmim jo normalisht të ulët sepse kosto e këtij pozicioni është rreth 400-450 euro. Pozicionin nr. 1 kategoria E 20%_Kërkesa e AK ka qenë që mbeturinat sipas pozicionit rregullimi i bubëzave te betonit (ne çmim te përfshihet stabilizimi i terenit , shtresa e materialit 0-31,5, shtresa nga tamponi , vendosja e bubëzave , ngjeshja etj.) Për të cilin OE-të e

paraqitura në tabelë për m² kanë ofruar çmim prej 4.00 euro. Këtu kemi të bëjmë me çmim manipulativ për arsye se nuk ka mundësi që të realizohet ky pozicion me një çmim prej 4.00 euro.

Për këtë pretendim ankimor të OE ankues, Paneli Shqyrtues sqaron se në bazë të llogaritjeve të ekspertit shqyrtues sipas Rregullave për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët për pozicionet si më poshtë ka rezultuar si me larte.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues duke u bazuar në Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, neni 3 dhe 4 Informatat e përgjithshme ku thotë: 3.1 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
- çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
- janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë. Neni 4 Procedura e shqyrtimit (inter partes)

4.1 Kur një tender konsiderohet si jo normalisht i ulët në pajtim me Nenin 61 të LPP dhe paragrafit 3.1 ose 3.2 të këtyre rregullave, një tender i tillë nuk mund të refuzohet pa hetimin dhe shqyrtimin e elementeve të rëndësishme që shkaktojnë tenderin veçanërisht të ulët.

4.2 Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë abnormalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkojë me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ulët, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevante të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ulët duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët".

4.3 Operatori Ekonomik do t'i përgjigjet me shkrim Autoritetit Kontraktues. Nëse jo, tenderi do të refuzohet.

4.7 Tenderuesi në fjalë do të informohet për rezultatin final të vlerësimit.

Më tej, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se bazuar në llogaritjet e bëra për pozicionet, ku OE ankues pretendon se janë ab-normalisht të ulët, konstaton se tek pozicioni nr.1,2,3 dhe 4, OE i rekomanduar për kontratë ka sjellë çmim jo-normalisht të ulët, dhe si rrjedhojë OE i rekomanduar për kontratë konsiderohet si ofertë ab-normal e ulët në pozicion në fjalë. Prandaj bazuar në sqarimet që u dhanë më lartë del ky pretendim ankimor është i bazuar.

Pretendimi tjetër i OE ankues është se OE N.N.P "HYSNIA" në shumicën e pozicioneve të paramasës dhe parallogaritë që përbëjnë lëndën kryesore të kontratës ka ofertuar me çmime manipulative/mashtrore që nuk korrespondojnë me pozicionet si në vijim: dhe çmimet reale të tregut (min e tavanit) dhe atë në Pozicionin nr.E 2_Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave deri në deponinë regjionale të menaxhuar nga UNITETI – për të cilin OE-të e paraqitura në tabelë për 1 Ton kanë ofruar çmim prej 2.50 euro. Kërkesa e AK ka qenë që mbeturinat sipas pozicionit 1 ngarkimi dhe transporti i mbeturinave deri në deponinë regjionale të menaxhuar nga UNITETI ndërsa çmimorja e deponisë KRM-"UNITETI" sh.a vetëm për hedhjen e

mbeturinave për këtë pozicion është çmimi prej 6.10 euro për ton që i bie se OE "HYSNIA" ka ofruar çmim jo normalisht të ulët me çmim prej 3.5 euro për ton, kur kemi parasysh edhe koston e transportit që i bie afër 15 km tregon që kemi të bëjmë me çmim manipulativ. Pozicionin nr, E 3. Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave ushqimore (mbetjet e asgjësimit) si dhe mbeturinat shtazore, deri ne deponinë regjionale te menaxhuar nga UNITETI – për të cilin OE-të e paraqitur në tabelë për 1 Ton ofruar çmim prej 2.50 euro. Kërkesa e AK ka qenë që mbeturinat sipas pozicionit 2 Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave ushqimore (mbetjet e asgjësimit) si dhe mbeturinat shtazore, deri ne deponinë regjionale te menaxhuar nga UNITETI ndërsa çmimorja e deponisë KRM-"UNITETI" sh.a vetëm për hedhjen e mbeturinave për këtë pozicion është çmimi prej 60.00 euro për ton që i bie se operatori ekonomik "HYSNIA" ka ofruar çmim jo normalisht të ulët me çmim prej 2.5 euro për ton, kur kemi parasysh edhe koston e transportit që i bie afër 15 km tregon që kemi të bëjmë me çmim manipulativ sepse ka ofruar një çmim prej 57.50 euro për ton më lirë se çmimi i hedhjes në deponi.

Paneli Shqyrtues sqaron se ekspertit shqyrtues ka bërë llogaritjet duke u bazuar në Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, si me larte.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues duke u bazuar në kategorinë E 20% e pikëve në vlerësim tek pozicionin nr.3 Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave ushqimore (mbetjet e asgjësimit) si dhe mbeturinat shtazore, deri ne deponinë regjionale te menaxhuar nga UNITETI. Dhe në pozicionin 2. Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave ushqimore (mbetjet e asgjësimit) si dhe mbeturinat shtazore, deri ne deponinë regjionale te menaxhuar nga UNITETI –OE "HYSNIA" ka ofruar çmim prej 2.50 € për këtë pozicion. Sa i përket këtyre pozicioneve, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues bazuar në llogaritjet e bëra konstaton se OE ka sjellë çmime jo-normalisht të ulëta ne të dy pozicionet. Bazuar në sqarimet që u dhanë më lartë del se ky pretendim ankimor qëndron.

Pretendimi tjetër i OE ankues është se OE N.P "Victoria Invest international "& MONDIAL SOL L.L.C në shumicën e pozicioneve të paramasës dhe parallogarisë që përbëjnë lëndën kryesore të kontratës ka ofertuar me çmime manipulative /mashtuese që nuk korrespondojnë me çmimet reale të tregut (min e tevanit) për disa pozicione ka ofruar çmime enorme të larta siç është pozicioni 1 Shënimi i trases se kanalizimit ku ka ofruar çmim prej 25.00 euro për m1 e disa pozicione të tjerë të cilët është dashur që AK gjatë vlerësimit ti vlerësoj dhe jo të shpall si të pa suksesshëm një operator i cili ka manipuluar me çmime. Po ashtu ka ofruar edhe çmime manipulative extreme të ulëta siq është pozicioni C7 furnizimi,planifikimi, shpërndarja dhe ngjeshja me cilindër adekuat 16 T te materialit nga gurëthyesi me fraksion 0-31mm, çmimi për m³ i ofruar prej 0.30 cent. Pozicionin nr.E 3._Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave ushqimore (mbetjet e asgjësimit) si dhe mbeturinat shtazore, deri ne deponinë regjionale te menaxhuar nga UNITETI – për të cilin OE-të e

paraqitura në tabelë për 1 Ton kanë ofruar çmim prej 15.00 euro. Kërkesa e AK ka qenë që mbeturinat sipas pozicionit 2 Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave ushqimore (mbetjet e asgjësimit) si dhe mbeturinat shtazore, deri ne deponinë regjionale te menaxhuar nga UNITETI –ndërsa çmimorja e deponisë KRM-“UNITETI” sh.a vetëm për hudhjen e mbeturinave për këtë pozicion është çmimi prej 60.00 euro për ton që i bie se operatori ekonomik “N.P Victoria Invest International”& MONDIAL SOL L.L.C” ka ofruar çmim jo normalisht të ulët me çmim prej 2.5 euro për ton, kur e kemi parasysh edhe koston e transportit që i bie afër 15 km tregon që kemi të bëjmë me çmim manipulativ sepse ka ofruar një çmim prej 45.00euro për ton me lirë se çmimi i hedhjes ne deponi.

Paneli Shqyrtues sqaron se ekspertit shqyrtues ka bërë llogaritjet duke u bazuar në Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët dhe dokumentacionin në lëndë, si me lartë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se duke u bazuar ne kërkesat e AK në dosje të tenderit, pozicionin nr.3 kategoria E 20%. Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave ushqimore (mbetjet e asgjësimit) si dhe mbeturinat shtazore, deri ne deponinë regjionale te menaxhuar nga UNITETI, po ashtu edhe Pozicionin 2 të kësaj kategorie. Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave ushqimore (mbetjet e asgjësimit) si dhe mbeturinat shtazore, deri ne deponinë regjionale të menaxhuar nga UNITETI –konstaton se pas llogaritjeve del se OE “N.P Victoria Invest International”& MONDIAL SOL L.L.C” ka sjellë çmime jo-normalisht të ultë për këto pozicione dhe si i tillë ky pretendim ankimor qëndron.

Pretendimi tjetër i OE ankues është se OE El-Bau sh.p.k me njoftimin për kontratë i cili është publikuar në Komunën e Vushtrrisë lidhur me projektin “Rikonstruimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale me Infrastruktur” ka analizuar paramasën të cilën e ka publikuar AK dhe për pozicionet në fjalë kemi marrë çmimoren për deponi në KRM “UNITETI”sh.a të cilën edhe gjatë ofertimit e kemi ngarkuar në sistemin elektronik të e-prokurimit me numër rendor 11 andaj duke ditur rëndësinë e këtij projekti ne i’u kemi përmbajtur plotësisht kërkesave të paraqitura në dosjen e tenderit, ndërsa Operatorët tjerë shihet se kanë manipuluar me çmime duke ofruar me çmime jo normalisht të ulëta, shtrohet pyetja si ka të drejtë që AK Komuna e Vushtrrisë të shpall fitues një Operator i cili ka ofruar çmim prej 56.50 euro apo 940% më lirë se kosto e deponimit, kur kihet parasysh se këtu hyn edhe kosto e transportit. Andaj kërkojmë nga AK që të bën vlerësimin duke u bazuar në kërkesat të cilat i ka paraqitur në dosjen e tenderit sepse AK ka kërkuar që mbeturinat të hedhen në deponi dhe jo në lumenj sepse çmimi me të cilin kanë ofertuar këta operator me këtë çmim mbeturinat rrezikohen të hedhen në lumenj dhe jo në deponi.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues duke u bazuar në dokumentacionin në lëndë konstaton se qëndron fakti se OE ankues ka bashkangjitur çmimoren nga KRU Uniteti dega Mitrovic, gjithashtu qëndron fakti se OE i rekomanduar për kontratë dhe OE të tjerë për të cilët ka pretendime ankimore në disa nga pozicionet se kanë sjellë çmime me të ulët në krahasim me çmimoren e KRM Uniteti, Paneli Shqyrtues

konform ekspertit shqyrtues pas krahasimit të çmimoreve të KRM UNITETI sh.a dhe çmimet në paramasat e OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit konstaton se OE në disa pozicione kanë ofruar çmime më të ulta, dhe si i tillë ky pretendim ankimor qëndron. Gjithashtu sa i përket këtyre pikave ankimore, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se bazuar në Njoftimin mbi vendimin e AK-së në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar ku AK ka dhënë për disa pozicione çmimin me TVSH referent nga hulumtimi i tregut dhe për të njëjtat pozicione OE "EING COM" SH.P.K, "AVAG GROUP" SH.PK, është eliminuar, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues duke u bazuar në neni 7 Barazia në trajtim/jo-diskriminimi ku thotë se: Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vjen në përfundim se AK nuk ka trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit pasi që edhe OE i rekomanduar për kontratë dhe OE tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit kanë sjellë çmime më të ulta në disa pozicione se sa çmimet referente të tregut nga ana e AK-së dhe në Njoftimin mbi vendimin e AK-së janë shpallur si të pasuksesshëm.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk i ka trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë operatorët ekonomik. Po ashtu, AK nuk ka pasur parasysh rregullat për tenderët jo normalisht të ulët, ku me rastin e vlerësimit nuk ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që të zbatojë të gjitha dispozitat e LPP-së me rastin e rivlerësimit, duke zbatuar rregullat për tenderët jo normalisht të ulët, si dhe të veprojë në harmoni me të gjitha pikat e nenit 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "KK-Vushtrri";
- 1x1 OE "El-Bau" SH.P.K-Gjilan;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.